



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E VERIFIKIMIT

Nr. 8422 / Prot.

Tiranë, më 19.09. 2018

NJOFTIM

Drejtuar: Autoriteteve Kontraktore

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të shkronjës "ç", të pikës 2, të nenit 13 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar dhe të nenit 11, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, ka rishikuar Formularin e Njoftimit të Fituesit në setin e Dokumentave Standarde të Tenderit për **Procedurën e Prokurimit "Shërbim Konsulence"**, të miratuara me Vendimin e APP Nr. 7, datë 12.01.2018.

Rishikimi i Formularit të Njoftimit të Fituesit, ka si qëllim të pasqyrojë informacion mbi numrin e operatorëve ekonomikë të kualifikuar, në fazën e parë të kësaj procedure prokurimi, për të cilën, sipas legjislacionit të prokurimit publik, kërkohen minimalisht 2 (dy) kandidatë.

Për këtë qëllim, në Shtojcën 17, Formulari i Njoftimit të Fituesit është shtuar seksioni përkatës ku, nga autoritetet kontraktore duhet të pasqyrohet edhe Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Reida Kashta

